

| | | |
|---|--|---|
|  | Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina |  |
|---|--|---|

| | |
|--------------------------------|---|
| Datë/a: | 18.03.2019 |
| Për/ Za/ To: | N.N.T." EING COM " Dumosh, Podujevë |
| CC: | Departamenti i Prokurimit |
| Nga/ Od/ From: | Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit Komuna e Prishtinës |
| Tema/ Subjekat/Subject: | Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës |



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/ A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për rishqyrtim** të datës 15.03.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "N.N.T." EING COM " lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i parkut ne lagjen Bregu I Diellit te Kompleksi I Banesave te Bardha", me Nr. të Prok: 616-18-7760-521,nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rivlerësim e parashtruar nga Operatori Ekonomik "N.N.T. Eing Com" të dt. 15.03.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i parkut ne lagjen Bregu I Diellit te Kompleksi I Banesave te Bardha", me Nr. të Prok: 616-18-7760-521, kundër Vendimit te AK -së, të datës 12.03.2018.
- 2..Aktiviteti pezullohet dhe kthehet në rivlerësim.
- 3.Autoriteti Kontraktues, vendos qe aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi i parkut ne lagjen Bregu I Diellit te Kompleksi I Banesave te Bardha", me Nr. Brendshëm 616 18 120 521 ta kthej në rivlerësim.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës me datë 12.03.2019 ka publikuar Njoftimin për vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit: " **Ndertimi i parkut ne lagjen Bregu I Diellit te Kompleksi I Banesave te Bardha** ", me Nr. Brendshëm 616 18 120 521.

Me datë 12.03.2019, Autoriteti Kontraktues ka njoftuar OE lidhur me rezultatet e aktivitetit te prokurimit duke dorëzuar Letrat Standarde për tenderuesit e suksesshëm/pasuksesshëm dhe eliminuar.

OE "N.N.T." EING COM ", me dt. 15.03.2019, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim., kundër vendimit te AK , në të cilin theksohet se AK ka *shkelur dispozitat e LPP, respektivisht:*

Neni 7: Barazia ne trajtim/Jo-Diskriminimi

Neni 59: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni:69: Aftësia teknike dhe profesionale;

Nenin 41 te RRUOPP-se;dhe \Nenin 41 te RRUOPP-së.

I njëjti lidhur me shkeljet e cekuar ka paarqitur dy pretendime:

1.Pretendimi i parë se tenderuesi i propozuar për kontratë nuk ka sjell dëshmi të reja e të mjaftueshme për të dëshmuar se i plotëson kërkesat teknike,respektivisht se nuk sjell dëshmi të mjaftueshme për paisjen traktor është e pa bazuar pasi që në raportin e vlerësimit dy anëtar kanë cekur në mënyrë të qartë se sipas dispozitave ligjore kjo paisje ka funksion primar bartjen apo shtyrjen e veglave të ndryshme,respektivisht lëvizjen e tyre,ndërsa qarkullimin në rrugë e ka funksion sekondar dhe mund të mos jetë i regjistruar.Po ashtu pretendimi se ajo paisje është kërkuar të ketë rregullësi teknike dhe regjistrim është plotësisht i pabazuar,pasi që në dosjen e tenderit nuk ekziston ndonjë kerkesë e tillë.

Poashtu duhet t'ua përkujtojmë se një procedurë tjetër me kerkesa të njëjta dhe për mjetin e njejtë si dhe për OE-ik të njejtë Vendimi i OSHP-se numër 654,655/18 ka saktësuar se fatura e blerjes(e njëjta) e plotëson kerkesën e Autoritetit Kontraktues.

2.Pretendimi i dytë ka të bëj me plotësimin e gabuar të paramasës,respektivisht me kalkulimin e gabuar të TVSH-së.Ky pretendim është i bazuar pasi që është konstatuar se gabime në normën dhe përlllogaritjen e TVSH-së ka dhe për këtë aktiviteti duhet të kthehet në rivlerësim dhe në atë proces duhet të bëhet një rivlerësim duke bërë korigjimet e parapara bazuar në dispozitat ligjore dhe interpretimet e KRPP-së që e rregullojnë çështjen e gabimeve të tilla në paramasë dhe parallogari.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

